



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/104  
Datë: 16.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 janar 2010, mori

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 50.000 (pesë dhjetë mijë) euro ndihmë shtetit të Haitit për përballimin e gjendjes së shkaktuar nga tërmeti.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*


---

Nr. 02/104  
Datë: 16.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6. të Ligjit Nr. 03/L-081 për Themelimin e Komisionit të Pavarur për Minierat dhe Mineratet, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 janar 2010, mori

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për anëtarë të Komisionit për Miniera dhe Minerale i propozon Kuvendit të Kosovës këta kandidatë:
  - a) Ahmet Tmava
  - b) Xhevdet Kastrati
  - c) Ibush Jonuzi
  - d) Shaip Latifi
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që propozimet nga pika 1. e këtij vendimi, së bashku me CV-të e kandidatëve, t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/104  
Datë: 16.01.2010


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 janar 2010, mori

**V E N D I M**

**Për plotësimin e Strategjisë Legjislative të vitit 2010 të Qeverisë së Republikës së Kosovës**

1. Në Strategjinë Legjislative të vitit 2010 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të përfshihet:
  - 1.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës;
2. Bartës i hartimit të Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, është Ministria e Punëve të Jashtme.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme që në pajtim me nenin 24 pika 2. të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, të dorëzojë në Zyrën për Shërbimet e Ndihmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit Projekt-programin e detajuar për Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-044 për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin Diplomatik të Republikës së Kosovës, i cili duhet të përmbajë Vlerësimin e Ndikimit Rregullativ, Ndikimin e Vlerësimit Financiar dhe Koncept Dokumentin, duke përfshirë edhe afatin për dërgim të projektligjit përfundimtar në Zyrën për Shërbimet e Ndihmës Juridike.

4. Zyra për Shërbimet e Ndhmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit pas marrjes së Projekt-programi të përcaktuar në pikën 3 të këtij Vendimi të plotësojë Strategjinë Legjislative të vitit 2010.
5. Ngarkohet Zyra për Shërbimet e Ndhmës Juridike në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/104  
Datë: 16.01.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 janar 2010, mori

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) euro për organizimin e Konferencës Ndërkombëtare për Persona të Pagjetur.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë.
3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë